

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7011
E martë, 3 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Komandanti i FSK-së kërkon
që Kosova të anëtarësohet në
Kartën e Adriatikut | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së
"ORGANIZATË TERRORISTE"? (2) | FAQE 4

GELBARDI LUAJTI ROL TË MADH NË PROCESIN E LEGJITIMIT TË UÇK-së NË PËRMASA NDËRKOMBËTARE



Hapin vendimtar në njohjen e UÇK-së nga aktorët kryesor të institucioneve ndërkombëtare e bënë SHBA-të dhe një rol të veçantë në këtë njohje ka luajtur ambasadori Gelbard.

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive, në vazhdimin e pjesës së dytë, ka folur për takimin që ka pasur atëkohë me ambasadorin Robert Gelbard dhe për bisedimet që kishin bërë për UÇK-në. Bardhyl Mahmuti ka theksuar se Gelbard ka luajtur një rol tepër të madh në procesin e legjitimitit të UÇK-së në përmasa ndërkombëtare dhe, pikërisht për këtë arsye, regjimi i Sllobodan Millosheviqit i ndërpreu kontaktet me ambasadorin Robert Gelbard. Në këtë intervistë ai flet edhe për propagandën serbe që paraqiste vrasjen e pjesëtarëve të aparateve represive si të ish-in civilë

MAVRAJ NDERON ISH-STUDENTËT E PROTESTËS SË 1 TETORIT TË '97-S: NDERIME PAKUFI! | FAQE 3



70 % E NXËNËSVE SHKOJNË NË SHKOLLË PA I PASUR TË GJITHA TEKSTET SHKOLLORE | FAQE 2



OPINION

EUFORIA PAS NGJARJEVE NË
VERI - KUNDËR ARSYES DHE
KUNDËR INTERESIT KOMBËTAR
DHE SHTETËTOR! | F. 9-10

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



AKTUALE



BE-ja: KOSOVA KA MANDAT
PËR HETIME, SERBIA TË
BASHKËPUNOJË PA KUSHTE | F. 2

REZOLUTA PËR SPECIALEN,
E INICIUAR NGA VEPRIMTARI SALI
BISLIMI, I SHKON QEVERISË
ZVICERANE, KËTA JANË DEPUTETËT
NËNSHKRUES | F. 6

EKONOMI



GRANTI PËR KOMUNAT
NË VITIN E ARDHSHEM ËSHTË
284.7 MILIONË EURO | F. 8

NIS ULJA E TARIFAVE NË ROAMING
BE - BALLKANI PERËNDIMOR | F. 8

SPORT

NAPOLI PA RRAHMANIN E PRET
REAL MADRIDIN | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja: Kosova ka mandat për hetime, Serbia të bashkëpunojë pa kushte

PRISHTINË, 2 TETOR - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë të hënën se Policia e Kosovës ka mandat për t'i hetuar sulmet që i janë bërë në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator, ndërsa Serbia e ka obligim të bashkëpunojë pa kushte. Ai i ka bërë këto deklarata teksa është pyetur për dëshmitë e fundit të publikuara nga autoritetet e Kosovës lidhur me këtë sulm.

Ai e ka përsëritur se BE-ja është në pritje të rezultateve të plota të hetimeve, që ta ketë një pasqyrë të qartë të asaj që ka ndodhur, dhe në bazë të tyre të marrin vendime vendet anëtare, përfshirë edhe ndonjë masë të mundshme ndaj Serbisë, raporton REL.

I pyetur rreth përgjegjësisë që e ka marrë ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoiçiq për sulmin, dhe a do të ndihmojë BE-ja që ai të ekstradohet në Kosovë, Stano ka thënë vetëm se

blloku evropian pret "bashkëpunim të plotë, transparent dhe pa kushte nga Serbia", në mënyrë që të sqarohet jo vetëm se kush e ka përgatitur dhe kryer sulmin terrorist, por edhe kush qëndron prapa tyre". "E kemi parë se çfarë ka thënë Radoiçiqi. Të gjitha faktet duhet të verifikohen dhe të zbardhen. Presim bashkëpunim të plotë nga Serbia. Ne nuk e bëjmë angazhimin tonë përmes medieve, por përmes kanaleve tona", ka thënë zëdhënësi i BE-së. I pyetur për deklaratat e Beogradit se misioni i BE-së në Kosovë për sundim të ligjit, EULEX, nuk është lejuar të marrë pjesë në hetime, Stano ka thënë se "EULEX-i nuk ka nevojë për zëdhënës që flet në emër të këtij misioni nga ana tjetër, por e ka zyrën e vet për këtë". "Secilën ditë dalin dëshmi të reja. Nuk i komentojmë, por presim rezultate përfundimtare që i



sqarojnë të gjitha rrethanat e sulmit terrorist. Presim bashkëpunim të plotë nga Serbia. BE ka thënë qartë se jemi gati të vendosim masa edhe ndaj Serbisë, nëse vendet anëtare vlerësojnë se kanë dëshmi të mjaftueshme", ka thënë Stano.

Zëdhënësi i BE-së nuk ka lënë asnjë dyshim se mandatin për ta hetuar rastin e Banjskës e kanë autoritetet e Kosovës. "Kjo ka ndodhur në territorin e Kosovës dhe hetimet i bën Policia e Kosovës. Ne kemi bashkëpunim shumë të mirë me të", ka thënë

ai. I pyetur se e ka kuptim vazhdimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në këtë situatë, pasi edhe Serbia në dhjetor mund të shkojë në zgjedhje, zëdhënësi i BE-së ka thënë se BE-ja dhe partnerët e saj e shohin pikërisht vazhdimin e dialogut si mënyrën e vetme për t'i zgjidhur problemet. "Gjithmonë ka cikle të zgjedhjeve. Por duhet ta rifillojmë dialogun, sepse është rruga e vetme për normalizim të raporteve. Sikur të kishte normalizim nuk do ta kishim situatën që kemi. Prandaj bëjmë thirrje nga BE-ja dhe partnerët që palët t'i kthehen dialogut", ka thënë Stano.

Kosova dhe Serbia janë pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizim të raporteve prej vitit 2011.

Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

Serbia kërcënoi direkt edhe trupat e NATO-s, shumë e gjatë lista që do të përgjigjet!



Burim RAMADANI

1. Besoj se NATO është në fazën e vlerësimit të saktë të të gjitha elementeve të përgjegjësisë direkte të Serbisë në

organizimin e grupit paramilitar për veprime terroriste në Kosovë.

Shkeljet serioze shtetërore që ka bërë Serbia do të adresohen në një listë të gjatë të pyetjeve për të cilat Vuçiqi do të përgjigjet domosdoshmërisht! Pyetjet nuk janë vetëm të përgjithshme, janë të detajuara në aspektin profesional për leadershipin, por edhe për strukturat e sigurisë në Serbi. Një prej tyre mund të jetë

siguria e bazave ushtarake të Serbisë, sa për ilustrim. Ato armë dhe ai arsenal i gjetur, nga vendi ku janë gjetur, me rrezën e veprimit ka mundur ta godasë edhe kampin Nothing Hill të KFOR-it.

Pra, Serbia përmes këtij grupi paramilitar ka kërcënuar direkt edhe trupat ushtarake të NATO-s.

2. Kjo temë e tejkalon nivelin mes

çështjeve të sigurisë apo politike Kosovë - Serbi. Kjo është, po ashtu, temë Serbi - NATO.

Sepse përtej të gjitha të tjerave, një numër i shteteve të NATO-s e kanë ndihmuar Serbinë ndër vite, ushtrinë serbe me armatim dhe me sisteme të pajisjeve.

Jam i bindur se ato shtete dhe NATO në tërësi do ta qartësojnë se cili është përdoruesi i fundit i pajisjeve dhe armatimit që i

kanë dhënë Serbisë.

A kanë mundur armët dhe sistemet e pajisjeve të shteteve të NATO-s të përfundojnë në grupe terroriste paramilitare? Ato armë të gjetura në Banjskë i janë dhënë grupit paramilitar direkt nga ushtria e Serbisë, e cila asnjëherë nuk e ka raportuar që ndonjë bazë e ushtrisë është thyer, vjedhur apo ka bankrotuar zinxhiri komandues. Prandaj, kjo lidhet me përgjegjësinë e Serbisë.

70 % e nxënësve shkojnë në shkollë pa i pasur të gjitha tekstet shkollë

PRISHTINË, 2 TETOR - Organizata ETEA ka realizuar një matje statistikore gjatë muajit shtator të vitit 2023 për furnizimin me tekstet shkollë të klasat 1-5 dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në fillimin e vitit shkollor 2022/23, duke marrë të dhëna konkrete mbi situatën aktuale në shkollat fillore të Kosovës, pas vendimit të MASHTI-t për ta ndryshuar procesin për furnizimin me tekste shkollë.

Për të parë se si qëndron situata në shkollat fillore të Kosovës - klasa 1-5 me furnizimin me tekste shkollë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor, organizata ETEA, përmes metodës sasiore, ka

grumbulluar të dhëna nga 506 responentë - të gjithë mësimdhënës/e të ciklit 1-5 - prej komunave nga e gjithë Kosova, përjashtuar komunat me shumicë serbe.

Komunat me numrin më të madh të anketave janë Prishtina me 23.1 % dhe Peja me 14.6 %. Në nivel klasash, numri më i lartë i responentëve janë mësimdhënës/e të klasës së 5-të (23.7 %), pasuar nga mësimdhënës/et e klasës së 3-të me (21.3 %).

Matjet nga të cilat dalin statistikave në fjalë janë kryer mes datave 14 dhe 22 shtator. Anketimi është kryer në formë elektronike.

Organizata ETEA mëson nga



matjet e kryera se një muaj pas fillimit të vitit shkollor 2022/23, 70.6 % e nxënësve/eve të Kosovës shkojnë në shkollë pa pasur në dispozicion të gjitha

tekstet shkollë. Mësimdhënës/et në shumicë prej 52.6 % konsiderojnë se vendimi i MASHTI-t ka pasur ndikim negativ në mbarëvajtjen e

procesit mësimor, krahas 14.8 % që konsiderojnë se vendimi ka pasur ndikim pozitiv.

Mungesa e teksteve shkollë të fëmijët lidhet me disa arsye, prej të cilave prijnë mungesa e teksteve shkollë nëpër libraritë e qytetit dhe problemet me transferimin e mjeteve financiare përmes platformës Kosova.

Lidhur me vendimin e MASHTI-t për ta ndryshuar procesin e furnizimit me tekstet shkollë, 30.4 % e mësimdhënësve/eve konsiderojnë se ministria duhet ta vazhdojë subvencionimin e prindërve/kujdestarëve/eve për blerjen e teksteve, derisa 69.6 % vlerësojnë se MASHTI duhet ta përmbyllë këtë proces përmes procedurave të prokurimit.

Mavraj nderon ish-studentët e protestës së 1 tetorit të '97-s: Nderime pakufi!

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - Muhamet Mavraj, një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s, me rastin e kujtimit të protestës së 1 tetorit të vitit 1997, i ka nderuar ish-studentët të cilët nuk janë më në mesin tonë, por që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në demonstrata dhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Fillimisht Mavraj me bashkëpunëtorë ka qëndruar në Mitrovicë. Ai ka bërë homazhe te varri i veprimtarit dhe liderit studentor nga Mitrovica, Ali Ahmeti, i cili ka ndërruar jetë një vit më parë. "Nuk të harrojmë Ali Ahmeti! Urime 1 tetorin. Dhe faleminderit për gjithë çfarë që bëre për Kosovën, në demonstrata e gjatë luftës! (Me unionet e studentëve të Mitrovicës 1997-99, babanë e Aliut, gruan dhe fëmijët, motrat, vëllezërit, shokët)", ka shkruar Mavraj në "Facebook".

Pas homazheve te varri i Ahmetit, Mavraj ka nderuar edhe Artim Jasharin, i cili ka rënë në mbrojtje të atdheut. "Nuk të harrojmë trim Artim Jashari! Urime 1 tetorin dhe faleminderit për gjithë çfarë që bëre për Kosovën, në demonstrata e gjatë luftës! Nderime pa kufi!", ka shkruar Mavraj.

Pas Mitrovicës, Mavraj ka qëndruar edhe në Prizren. Ai në

Korishë të Prizrenit ka nderuar Sedat Kabashin për kontributin e tij në demonstrata. "Nuk të harrojmë Sedat Kabash! Urime 1 tetorin dhe faleminderit për gjithë çfarë që bëre për Kosovën, në demonstrata e gjatë luftës! (Në Korishë, me familjen e ngushtë e të gjerë të Sedatit, Laurën me djemtë, motrat, vllaznitë, ish-Unionin e Prizrenit e plot bashkëluftëtarë. I falënderojmë fort për pritjen e dashurinë për Sedatin!", ka shkruar Mavraj.

Në Prizren Mavraj me bashkëpunëtorë ka vizituar edhe rrugën "1 Tetori" për ta nderuar grupin e liderëve studentorë prizrenas. "Prizren. Në këtë rrugë pati një histori të 1 tetorit dhe ky emër i ri mbuloi të vjetrin. Sot jam këtu, në Prizren, për ta nderuar grupin e liderëve studentorë prizrenas që vuajti burgje të rënda dhe mbeti dinjitoz. Urime 1 tetorin dhe faleminderit për gjithë çfarë bëtë për Kosovën, në demonstrata e gjatë luftës!", ka shkruar Mavraj.

Po ashtu, Mavraj ka nderuar në Istog edhe shokun e tij, Nazmi Muzlija, i cili ka rënë dëshmor në mbrojtje të atdheut. "Nuk të harrojmë patriot Nazmi Muzlija! Urime 1 tetorin dhe faleminderit për gjithë çfarë bëre për Kosovën, në demonstrata e gjatë luftës! Mbetesh shok monumental. Nderime pa kufi!", ka shkruar Mavraj.



Më 1 tetor 1997 Lëvizja Studentore kishte organizuar protesta për ta kundërshtuar pushtimin serb në Kosovë si dhe për t'i rikthyer studentët në objektet universitare, të cilët atëkohë ishin dëbuar nga regjimi serb i cili në krye kishte

Slobodan Millosheviqin. Në ballë të protestës së '97-s ishin liderët e Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, së bashku me rektorin e atëhershëm të Universitetit të Prishtinës, Ejup

Statovci. Pas tyre, në këtë protestë ishin edhe mijëra studentë dhe profesorë. Lëvizja Studentore e '97-s, nga historianët e njohur të Kosovës, është vlerësuar krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare i Kosovës.

DREJTORI I AKI-SË RAPORTON PËR SITUATËN NË VERI

Serbia po ndërton bazë ushtarake afër kufirit me Kosovën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Intelgjencë, Petrit Ajeti, ka raportuar të hënën për situatën në veri në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Intelgjencë në Kuvendin e Kosovës.

Pas mbledhjes, kryetarja e Komisionit, Ganimete Musliu, para medieve ka konfirmuar se Serbia është duke ndërtuar një bazë ushtarake në afërsi me kufirin e Kosovës. "Janë vërejtur ushtri në kufi. Është konfirmuar se në zonën e njohur të Izvorit po ndërtohet një bazë ushtarake. Pra, kjo po ndërtohet në afërsi me kufirin me Kosovën. Pamjet me dronë kanë konfirmuar këtë. Gjendja e sigurisë është e brishtë dhe e tensionuar. Duhet të jemi të kujdesshëm ndaj çdo provokimi të mundshëm", ka deklaruar ajo. Musliu ka thënë se tashmë duhet të jenë të gjithë së bashku, pozita dhe opozita, pasi që në pyetje është siguria e vendit. "Dua të theksoj me bindje të plotë se AKI së bashku me forcat e rendit ishin




në krye të detyrës në mbrojtje të vendit. E kam potencuar se siguria e vendit është mbi interesat partiake. Kishte pretendim të mbajtjes së tensioneve dhe të krijoheshin tensione në Kosovë. Anëtarët e AKI-së e kanë dëshmuar

profionalizmin dhe në bazë të fakteve që janë paraqitur, grupet terroriste kanë hyrë përmes rrugëve ilegale", ka thënë deputetja Musliu. Është bërë një javë nga sulmi terrorist ndaj Policisë së Kosovës që ndodhi në Banjskë të Zveçanit,

ku i vlarë mbeti rreshteri Afrim Bunjaku dhe u plagos zyrtari tjetër policor Alban Rashiti. Policia e Kosovës ka vazhduar operacionet në veri, duke konfiskuar arsenal armësh në zonën ku ndodhi sulmi, përfshirë: granatahedhës, antiplumb, karikatorë me fishekë,

kapela ushtarake, dorëza, pushkë gjuetie, snajperë, radiolidhje etj. Të gjitha këto, sipas Policisë së Kosovës, i takonin grupit të armatosur terrorist i cili përbëhej nga më shumë se 30 veta, të cilët, pas sulmit, u fshehën në Manastirin e Banjskës.



• Hapin vendimtar në njohjen e UÇK-së nga aktorët kryesor të institucioneve ndërkombëtare e bënë SHBA-të dhe një rol të veçantë në këtë njohje ka luajtur ambasadori Gelbard.

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (2)

Gelbardi luajti rol të madh në procesin e legjitimitimit të UÇK-së në përmasa ndërkombëtare

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive, në vazhdimin e pjesës së dytë, ka folur për takimin që ka pasur atëkohë me ambasadorin Robert Gelbard dhe për bisedimet që kishin bërë për UÇK-në. Bardhyl Mahmuti ka theksuar se Gelbardi ka luajtur një rol tepër të madh në procesin e legjitimitimit të UÇK-së në përmasa ndërkombëtare dhe, pikërisht për këtë arsye, regjimi i Sllobodan Millosheviqit i ndërpreu kontaktet me ambasadorin Robert Gelbard. Në këtë intervistë, ai flet edhe për propagandën serbe që paraqiste vrasjen e pjesëtarëve të aparateve represive si të ishin civilë

PRISHTINË, 2 TETOR-

“Epoka e re”: T’i kthehem edhe një herë takimit me ambasadorin Gelbard. Siç raportuan mediet e asaj kohe, ai e kishte cilësuar UÇK-në “organizatë terroriste” dhe se gjatë vizitës në Prishtinë kishte kërkuar nga forcat politike

të Kosovës të distancoheshin prej saj. A diskutuat rreth kësaj çështjeje?

Bardhyl Mahmuti: Ne ishim në dijeni të asaj që kishin transmetuar mediet për qëndrimin e z. Gelbard, por ishim marrë vesh me Ramadan

Avdiun që të mos hynim në këtë temë. Ishte ambasadori Gelbard që hapi këtë temë. Fillimisht na tha se deklarata e tij ishte keqinterpretuar nga mediet dhe na siguroi se ai nuk e kishte cilësuar UÇK-në si “organizatë terroriste”, por kishte deklaruar se “UÇK-ja kishte kryer edhe aksione terroriste” dhe kërkoi sqarime për “vrasjen e civilëve nga ana jonë”.

“Epoka e re”: Na falni për ndërhyrjen. A i besuat z. Gelbard se mediet kanë manipuluar me deklaratën e tij?

Bardhyl Mahmuti: Është fakt se ne nuk kemi qenë në takimet e ambasadorit Gelbard në Prishtinë dhe as në kontaktin që ka pasur me gazetarët kur është folur për UÇK-në. Për ne ishte shumë e rëndësishme atë që

dëgjonim nga goja e tij. Meqë ra fjala për këtë çështje, do të ndajmë me lexuesin diçka nga bisedat private të asaj kohe. Pasi u bë publike takimi ynë, disa herë më është shtruar pyetja nga miqtë e mi “përse nuk i kam kërkuar z. Gelbard kërkimfalje publike për fyerjet që na i ka bërë”? Një qasje e tillë e marrëdhënieve diplomatike do të na dëmtonte jashtëzakonisht shumë dhe as që na ka shkuar ndërmend një ide e tillë. Një shprehje shumë e bukur popullore, që përdoret në Kosovë, i shkon kësaj situatë: *Duhet t’ia dish hallin vetit!* Ne ishim plotësisht të vetëdijshëm për pozitën tonë reale.

“Epoka e re”: Në intervistën ekskluzive që keni dhënë si përfaqësues politik i UÇK-së, që u

botua në shtator të vitit 1998 në *“Zëri i Kosovës”* dhe *“Bota e re”*, ju i atribuoni z. Gelbard merita në procesin e legjitimitimit të UÇK-së në përmasa ndërkombëtare.

Bardhyl Mahmuti: Është tërësisht e vërtetë! Ai ka luajtur një rol tepër të madh në këtë drejtim dhe, pikërisht për këtë arsye, regjimi i Sllobodan Millosheviqit i ndërpreu kontaktet me ambasadorin Robert Gelbard. Fatkeqësisht njerëzit kanë mbajtur në mend gjërat negative për vërtetësinë e të cilave nuk janë të sigurt dhe harrojnë këto merita të mëdha të këtij diplomati amerikan.

“Epoka e re”: Cili ishte sqarimi juaj lidhur me pretendimin e vrasjes së civilëve nga ana e UÇK-së?

Bardhyl Mahmuti: Edhe në këtë

takim përsëritëm atë që kishim thënë në konferencat e shumta që kishim mbajtur në Selinë e Kombeve të Bashkuara nga muaji mars i vitit 1998: cak i sulmeve të UÇK-së janë pjesëtarët e aparateve represive serbe (ushtrisë, policisë, shërbimeve sekrete...) qofshin në uniforma, qofshin pa uniforma! Pjesëtarët e aparateve represive pa uniformë nuk mund të konsiderohen si caqe civile, sepse janë pjesë e strukturave shtetërore që ishin bartëse të dhunës kundër shqiptarëve në Kosovë.

“Epoka e re”: Fakti se pas takimeve me përfaqësues të ShBA-së zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Xhems Rubin, hodhi poshtë cilësimin “terrorist” që i vishej UÇK-së, është dëshmi se shpjegimet që keni dhënë kanë qenë bindëse. A keni ndonjë rast konkret të propagandës serbe që paraqiste vrasjen e pjesëtarëve të aparateve represive si të ish civilë?

Bardhyl Mahmuti: Vrasja e dy serbëve, Ilija Vujoševi (Vujoševiq) dhe Dejan Djetlovit, e ilustron shumë mirë këtë propagandë. Më 6 nëntor 1998 mediet serbe njoftuan se

në këtë ditë, në orën 11:00, në fshatin Dubravë të komunës së Rahovecit, “në territorin e kontrolluar nga terroristët e UÇK-së ishin zhdukur dy serbë: Ilija Vujoševi dhe Dejan Djetlov”, ndërkaq më 9 nëntor publikuan fotografitë e tyre të vrarë! Pas spekulimeve të shumta që i bënë mediet serbe kësaj vrasjeje të shoqëruar me fotografitë e dy serbëve të vrarë, në veshje civile, në botimin e janarit të vitit 1999, në atë të vitit 2000 dhe atë të vitit 2001, Shërbimi Sekret Serb pranoi se fjala ishte për “dy punonjës të Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Prishtinës, të cilët ishin vrarë në detyrë ‘humanitare’. Ata kishin qenë duke furnizuar me ushqim njësitë e forcave policore që luftonin me terroristët shqiptarë”. Publikimi disa muaj më vonë, në libra që u shpërndaheshin institucioneve ndërkombëtare dhe medieve kryesore që çonin peshë në krijimin e opinionit publik ndërkombëtar, i të vërtetës se bëhej fjalë për policë të vrarë, nuk e zhbënte efektin e parë që pati shpërndarja e fotos së “personave të vrarë në veshje civile”. Kjo teknikë e propagandës serbe pati efekte

shumë të mëdha për krijimin e opinionit se “UÇK-ja vriste civilë”.

“Epoka e re”: Me sa kemi njohuri, teknika e paraqitjes si “civilë” të pjesëtarëve të aparateve represive serbe të vrarë nga UÇK-ja, ka vazhduar edhe pas luftës. Ky aspekt është trajtuar më gjerësisht në veprën tuaj “Mashtrimi i madh”. A ndryshoi diçka rreth kësaj mënyre veprimi pas përmbysjes së Sllobodan Millosheviqit dhe ndërrimit të pushtetit në Beograd?

Bardhyl Mahmuti: Rrëzimi i Sllobodan Millosheviqit nga pushteti politik nuk solli asnjë ndryshim pozitiv në strukturat e aparateve represive. Edhe pas vrasjes së kryeministrit serb Zoran Gjingjiq (12 mars 2003), strukturat mbetën të njëjta. Përveç shefit të Shërbimit Sekret të Serbisë, Radomir Markoviqit, udhëheqësit të Njësisë për Operacione Speciale, Millorad Ulemek-Llegija, dhe zëvendësit të tij, Dushan Mariqiq Gumar, asnjë nga pjesëtarët e Sigurimit Shtetëror nuk u largua nga detyra. Përkundrazi, me anë të transferimeve të kuadrove nga një drejtori në tjetrën, një pjesë e

madhe e pjesëtarëve të këtij shërbimi u ngritën në funksione edhe më të larta. Po marr vetëm një shembull për ta ilustruar këtë. Në krye të Seksionit të Parë të Kundërzbulimit të Qendrës Beograd ishte Goran Zhivkoviq (Živkovi), ndërsa në krye të Seksionit të Dytë ishte Misha Milliçeviq (Miša Mili evi). Të dy u arrestuan për vrasjen e kryeministrit serb dhe të dy u liruan në “mungesë provash”. Në vend të ndëshkimit, ata fillimisht u shkarkuan nga detyrat që kishin në kuadër të Shërbimit për Beogradin si Qendër dhe, pak kohë më vonë, u emëruan në funksionet më të larta të Shërbimit Sekret të Serbisë! Kështu, ish-shefi i Seksionit të Dytë të Kundërzbulimit për Beogradin, Miša Mili evi, u emërua shef i Agjencisë Informative të Sigurisë (BIA), ndërsa ish-shefi i Seksionit të Parë të Kundërzbulimit të Qendrës Beograd, Goran Zhivkoviq, u bë zëvendës shef i Agjencisë Informative të Sigurisë (BIA). Janë pikërisht këta njerëz që kishin sajuar dosjen “Viktimat e terrorizmit shqiptar në Kosovë dhe Dukagjin - Personat e vrarë, të rrëmbyer dhe të zhdukur

janar 1998-nëntor 2001” (Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji- Ubijena, oteta i nestala lica, januar 1998 - novembar 2001), që u publikua dhe u shpërnda në emër të Qeverisë së Serbisë, ndërkaq në shtator të vitit 2003 publikuan dosjen kundër pjesëtarëve të UÇK-së “Terrorizmi shqiptar dhe krimi i organizuar në Kosovë dhe Dukagjin” (Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji) dhe shpërndanë në institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe ato të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë disketat me 27 000 faqe materiale të sajuara për gjoja krimet e UÇK-së. Në këto materiale të sajuara nga Shërbimi Sekret i Serbisë dhe të shpërndara nga Qeveria e re “demokratike” e Serbisë, një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të aparateve represive të vrarë nga UÇK-ja, të cilët gjatë kohës së regjimit të Sllobodan Millosheviqit figuronin në listën e policëve të vrarë, prezantohen si “civilë të vrarë, të rrëmbyer ose të zhdukur nga UÇK-ja”.

(Muhamet Mavraj / Vijon)



Policët serbë Ilija Vujoševi dhe Dejan Djetlov të vrarë në “veshje civile”
(Foto nga libri: “Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija”, f. 559)

Rezoluta për Specialet, e iniciuar nga veprimtari Sali Bislimi, i shkon qeverisë zvicerane, këta janë deputetët nënshkrues

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 TETOR - Drejtori i organizatës "Zëri Perëndimor i Kosovës", njëherësh edhe drejtor i zyrës ligjore "First-consulting.ch" në Bern të Zvicrës, Sali Bislimi, ka arritur të mbledhë 30 nënshkrime të deputetëve zviceranë nga të gjitha partitë politike për rezolutën e paraqitur për Gjykatën Speciale për të cilën ai ngre dyshime.

Rezoluta e iniciuar nga "Zëri Perëndimor i Kosovës" i është dorëzuar tashme qeverisë zvicerane, nga e cila kërkohet kujdes për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për ish-presidentin Hashim Thaçi dhe të tjerët që po mbahen në paraburgim në Hagë për gati tri vjet.

"Zëri Perëndimor i Kosovës" përmes një njoftimi për medie ka bërë me dije se Bislimi përmes kësaj rezolute kërkon që të ketë respektim të procedurave

gjyqësore dhe një gjykim të drejtë në nivel ndërkombëtar.

Në rezolutë theksohet se çlirimtarët e Kosovës, pavarësia e të cilëve de facto dhe de jure u njoh menjëherë nga Zvicra, po përballen me një procedurë të rëndë penale.

"Në veçanti, ish-presidenti Hashim Thaçi aktualisht ndodhet në paraburgim në Hagë. Procedura i ngjan një njeje të vërtetë gordiane, pasi që në këtë fazë duket se ndikimet e jashtme politike kundër ish-presidentit Thaçi po ndërhyjnë në mbajtjen e një gjykimi të drejtë. Duket qartë se hetimi i kryer nga drejtësia ndërkombëtare kundër tij sugjeron në mënyrë të arsyeshme një paragjykim dhe vë në masë të madhe në pikëpyetje vërtetësinë e fakteve me të cilat ai akuzohet", theksohet në rezolutën, e cila tashmë ka hyrë në objektin e parlamentit të Zvicrës.

Sali Bislimi thotë se kjo është një rezolutë, simbol i shpresës në të




vërtetën juridike dhe morale! Nënshkruesit e rezolutës janë: Gerhard Pfister - kryetar i Partisë së Qendrës "Die mitte /Le Centre"; nënkryetari, senator i kësaj partie Charles Juillard; Philippe Nantermod nënkryetar i partisë

liberale radikale FDP/PLR. **Deputetët nënshkrues:** Michel Matter, Jean Pierre Grin, Weber Celine Fabien Fivaz, Jacqueline de Quattro, Alfred Heer, Michael Buffat, Elisabeth Schneider-Schneiter, Daniel Ruch, Pierre

Andre-Page, Christine Bulliard, Manfred Buhler, Pierre Alain Fridez, Olivier Français, Maitre Vincent, Alexandre Berthoud, Thomas Brunner, Pointet François, Christa Markälder, Léo Muller, Irène Kalin, Heinz Siegenthaler, Mettler Melanie, Zopfi Mathias, Mathilde Crevoisier Crelier, Andreas Meier, dhe Patricia von Falkenstein.

Sali Bislimi është një veprimtar i cili jeton dhe vepron në Zvicër. Ka lindur në Topillë të Shtimes, por kontributi i tij për shtetin e Kosovës është i madh. Ai në mënyra të ndryshme nga Zvicra e ka ndihmuar Kosovën. Ai nga Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet është nderuar me dekoratën "Ambasador i Paqes". Gjithashtu, Sali Bislimi nga presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, është nderuar me "Urdhrin e Pavarësisë". Urdhri i Pavarësisë u jepet personave që kanë dhënë kontribut të lartë për pavarësinë e Kosovës.



UShAF fillon vitin e ri akademik

FERIZAJ, 2 TETOR - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ka hapur dyert të hënën për të pritur në një ceremoni solemne studentët në vitin e ri akademik 2023/24, në veçanti ata të cilët për herë të parë fillojnë studimet në universitet.

Rektori i UShAF, prof. dr. Agron Bajraktari, u dëshiroi mirëseardhje në Universitet studentëve, në veçanti atyre që për herë të parë fituan statusin e studentit. "Ndihem shumë mirë dhe njëkohësisht i emocionuar që po fillon viti i

ri akademik në ambientet e universitetit tonë. Ju jemi falënderues dhe shumë mirënjohës, juve studentët të dashur, po edhe familjeve tuaja që keni zgjedhur institucionin tonë dhe na keni besuar t'u ndihmojmë në ngritjen tuaj profesionale. Ju premtojmë se nuk do të zhgënjeheni me vendimin tuaj, gjë që do ta vërtetoni gjatë studimeve. Kjo tanimë është shtëpia juaj dhe dyert e gjithë stafit, në veçanti e imja do të jetë e hapur gjithmonë për bashkëpunim me secilin prej jush me qëllim që përmes

bashkëpunimit t'i realizojmë synimet tona drejt suksesit tuaj në të ardhmen", ka thënë rektori Bajraktari.

Kryetari i Këshillit Drejtues të UShAF-it, Hazir Gashi, u uroi mirëseardhje studentëve dhe i porositi ata që të fillojnë tani angazhimin e tyre dhe të bëhen profesionistë nga institucioni, i cili u garanton të ardhme të suksesshme, ku me njohuritë e tyre do të kontribuojnë për shtetin tonë, për një të ardhme më të ndritur për vendin tonë.

Ndërsa kryetarja e Parlamentit Studentor e UShAF, Leona



Jahiri, ka thënë se për ne është nder që çdo vit e më shumë familja jonë po zgjerohet dhe interesimi për t'u bërë pjesë e jona është shumë i madh. Ky interesim dhe entuziazëm,

sipas saj, po vjen falë angazhimit dhe përkushtimit që po tregon menaxhmenti i universitetit, profesorët dhe bizneset partnere të universitetit.

Haradinaj kërkon hetim ndërkombëtar për t'i zbardhur skenarët e fundit në veri

PRISHTINË, 2 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar sërish të hënën për situatën e fundit në veri. Ai ka thënë se shtimi i numrit të pjesëtarëve të KFOR-it brenda mandatit që ka dëshmon vendosmërinë e NATO-s se terrorizmi nuk kalon. "Paqja në Kosovë e në Ballkan është vendosur me shumë dhimbje e tragjedi, prandaj nuk do të lejojmë

askënd që ta rrezikojë atë. Si Kosovë qëndrojmë fuqishëm në mbështetje të të drejtave politike të të gjitha komuniteteve, edhe të komunitetit serb, në bazë të Kushtetutës, ligjeve të Kosovës dhe në bazë të planit franko-gjerman të përkrahur nga Amerika", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Ai ka theksuar se faktet që po zbardhen përditë dëshmojnë për implikimin e thellë të

Serbisë në organizimin e akteve terroriste në veri dhe shteti i Serbisë nuk mund t'i ikë përgjegjësisë. "Prandaj kërkohet një hetim ndërkombëtar për t'i zbardhur skenarët e destabilizimit jo vetëm të Kosovës por edhe të Ballkanit dhe për t'i nxjerrë para drejtësisë të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në këto sulme terroriste", ka thënë Haradinaj.



Lansohet fushata ndërgjegjësuere me moton "Zbulimi i hershëm shpëton jetë"



"Epoka e re"

PRISHTINË, 2 TETOR - Me rastin e muajit tetor, Muajit të Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit, kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në lansimin e fushatës ndërgjegjësuere me moton "Zbulimi i hershëm shpëton jetë". "Nga të gjitha vdekjet nga kanceri, 1 në 7 vdekje vjen nga kanceri i gjirit. Përderisa shkenca nuk ofron një qasje parandaluese, fokusi është në

zbulimin e hershëm të sëmundjes. Për këtë angazhohemi bashkë, me investimet në sistemin tonë shëndetësor dhe me rritjen e vëmendjes dhe të vetëdijes për rëndësinë e ekzaminimeve rutinore", u shpreh kryeministri Kurti. Si qeveri, shtoi më tej ai, përkushtimi i tyre është i përditshëm, që të sigurojnë qasje sa më të lehtë dhe të barabartë në shërbimet shëndetësore, për zbulimin e hershëm dhe për

trajtimin e kancerit të gjirit, për të gjithë qytetarët, duke siguruar qasje shumëdisiplinare. "Në këtë betejë për jetën, Ministria e Shëndetësisë po vepron për zgjerimin e hartës së shërbimit të kemioterapisë dhe terapisë tabletare në spitale rajonale. Kemi decentralizuar shpërndarjen e terapisë tabletare në Spitalin e Prizrenit dhe jemi në përgatitje të decentralizimit edhe të shërbimit të kemioterapisë për ta sjellë shërbimin sa më afër qytetarëve. Me vendosmërinë

tonë për t'i siguruar barnat për qytetarët tanë që përballen me sëmundje, edhe e kemi rritur ndjeshëm buxhetin për barna. Kosova sot ka dy pajisje të gjeneratës së fundit për radioterapi, akceleratorë linearë, si dhe listë të pritjes në norma më optimale në raport me vendet e rajonit", ka theksuar kryeministri. Statistikat tregojnë se përhapja e kancerit të gjirit është 1 në 8 gra, mirëpo paraqitet edhe te burrat, por me shkallë më të ulët të rrezikut, 1 në 100 raste.

Në këta nëntë muaj të vitit 2023, 332 pacientë janë diagnostikuar me kancer të gjirit. Kryeministri Kurti u bëri thirrje të gjitha grave dhe vajzave, por edhe burrave e djemve, që të kujdesen për veten, duke vizituar mjekun e afërt, e duke u kontrolluar edhe kur mund të mos kenë shqetësime. Në fund të fjalës së tij, Kurti tha se të gjitha grave që po luftojnë me vendosmëri për jetën, u themi se nuk janë vetëm dhe se luftën do ta bëjmë bashkë dhe sëmundjen do ta mposhtim bashkërisht.

Universiteti i Prishtinës, pjesë e konferencës së EAIE-s në Roterdam

PRISHTINË, 2 TETOR - Universiteti i Prishtinës, i përfaqësuar nga prorektorja Basha Jakupi, do të marrë pjesë në konferencën e EAIE (EAIE European Association for International Education) në Roterdam. Konferenca e EAIE-s shërben si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave në fushën e arsimit të lartë ndërkombëtar. Universiteti i Prishtinës në veçanti përfiton nga një rrjet i

konsiderueshëm i partneriteteve, i cili ka rezultuar në një numër iniciativash dhe shkëmbimesh akademike. Një tregues i njohurive të marra dhe reputacionit të zhvilluar në fushën e arsimit të lartë është interesimi unik për bashkëpunim që është treguar me Universitetin e Prishtinës në këtë drejtim. Më shumë se 9 000 njerëz janë regjistruar për konferencën,

duke përfshirë delegatë nga institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë. Pjesëmarrja në EAIE ripohon përkushtimin ndaj ndërkombëtarizmit dhe veprimeve tona për t'i marrë standardet globale të arsimit të lartë. Universiteti i Prishtinës është i vendosur për ta mbajtur përkushtimin e tij ndaj internacionalizimit dhe për ta ngritur nivelin e arsimit të lartë në nivel global.



Granti për komunat në vitin e ardhshëm është 284.7 milionë euro

PRISHTINË, 2 TETOR - Një minutë heshtje është mbajtur për rreshterin e rënë në detyrë, Afrim Bunjaku, në takimin e përbashkët me kryeministrin Albin Kurti, ministrat e linjës dhe kryetarët e komunave të hënën.

Kurti u shpreh se ky takim i gjen me një lajm të mirë, atë për organizimin e Lojërave Mesdhetare në vitin 2030. Sipas tij, komunat do të kenë mundësi të përfitojnë shumë investime. "Ky format na shërben që përmes diskutimit të kujdesemi për mirëqenien e qytetarëve. Po bëhet viti i dytë që rritja e buxhetit është me shifra të larta, e buxheti i vitit 2024 do të jetë 90 milionë euro më i lartë se viti paraprak. Granti i përgjithshëm për vitin e ardhëm është 284.7 milionë euro", ka thënë Kurti.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, ka kritikuar qeverinë për qasjen komunikuese, po ashtu edhe për Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Tatimin në Pronë. "Ne kryetarët e komunave kemi bindjen që duhet të ndryshojë qasja komunikuese. E tillë është edhe qasja për Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, për të cilën

AKK-ja u përjashtua nga konsultimi, duke cenuar kështu edhe autonominë lokale", u shpreh Aliu, duke përsëritur edhe njëherë kërkesat e komunave për qeverinë. "1. Themelimi i Grantit të Katërt që do të krijojë barazi për komunat e Kosovës. 2. Përshpejtimi i procedurave për nxjerrjen e akteve nënligjore (në bazë të Ligjit të ri për Zyrtarët Publikë) që rregullojnë

procedurat e rekrutimit në komuna, me theks lejinin e listës pritëse në arsim dhe shëndetësi. 3. Kthimin e pronave të menaxhuara aktualisht nga Agjencia Kosovare e Pronave, në menaxhim të komunave, prona këto që janë përcaktuar dhe të shpallura nga komunat për interes publik e për të cilat komunat i kanë nisur procedurat e projekteve dhe kanë njoftuar me shkrim nivelin

qendror. Këtu më lejoni që të vë spikamën edhe në nevojën e ndërmarrjes së veprimeve të shpejta, përkritazi me këto prona, kur së fundmi, siç dihet, jemi përzgjedhur për organizimin e Lojërave Mesdhetare, e ku parashihen investime të shumta në infrastrukturë sportive, po kështu edhe ndërtimi i kapaciteteve të reja sportive - stadimeve për të cilën

kemi nënshkruar marrëveshjet me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Këto fakte e bëjnë të menjëhershme nevojën e reagimit nga niveli qendror, për të mundësuar zhvillimin e projekteve në këto prona, kur dihet mirëfilli se shumë nga komunat nuk kanë hapësira në pronësi komunale që do t'u mundësonin zhvillimin e këtyre projekteve", ka thënë Aliu.

Më tej, Aliu përmendi kërkesën e radhës: "Të krijohen mekanizma ligjorë për bartjen e pronave të menaxhuara nga Agjencia e Pyjeve për zhvillim të projekteve si dhe në raste të tjera të ketë shmangie të procedurave burokratike për dhënien e lejeve për zhvillim të projekteve komunale të cilat bartin interesin publik mbi të gjitha. 5. Të mos lejohet që zonat ekonomike në komuna të kalojnë në përgjegjësi të nivelit qendror, por të vazhdojnë të administrohen nga komunat. 6. Të rikthehet Projektligji për Prokurimin Publik për plotësim-ndryshime sepse aktualisht po shkakton telashe e vonesa në nivelin lokal për kryerje të shumë punëve dhe zhvillim të projekteve".



Nis ulja e tarifave në roaming BE - Ballkani Perëndimor

PRISHTINË, 2 TETOR - Deklarata për Roaming BE - Ballkani Perëndimor, e nënshkruar në Samitin BE - Ballkani Perëndimor në Tiranë më 6 dhjetor 2022, ka hyrë zyrtarisht në fuqi, duke shënuar kështu datën e një ndryshimi të madh.

Pas gati një viti pune të përbashkët intensive të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Komisionit Evropian, si edhe me mbështetjen politike të BE-së dhe BP-së, operatorët e telekomunikacionit të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian jo vetëm i kanë plotësuar kërkesat e deklaratës, por në shumë raste i kanë tejkaluar pritshmëritë. Duke nisur nga ky tetor, kufiri i çmimit për 1 GB roaming i të dhënave në kuadër të ofertave dhe paketave speciale, në përputhje me Deklaratën e Roaming, nuk duhet t'i kalojë 18 euro, duke e bërë kështu udhëtimin dhe komunikimin mes BE-së dhe BP-së dukshëm më ekonomik. Në shumë raste kufiri i çmimit prej 18 eurosh brenda



ofertave dhe paketave speciale shkon edhe shumë më i ulët deri në 1.6 euro për 1 GB, ndërsa tre operatorët të Ballkanit Perëndimor, krahas çmimeve të paketave të ulura edhe të rregullta, do të operojnë dhe me çmimet sipas modalitetit "pay as you go" (që do të

thotë se nuk duhet të blesh asnjë paketë ekstra, ndërsa udhëton, veçanërisht për udhëtime të shkurtra). "E kisha premtuar në fjalimet e mia, një vit më parë se çmimet e roaming-ut ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor do të binin bashkë me gjethet e vjeshtës.

Nëse dikush kishte ndonjë dyshim, sot s'do të kenë më asnjë arsye, ndaj sot jam e kënaqur që fjalët e mia do të tingëllojnë qetësuese dhe bindëse për të gjithë. Ky zhvillim historik tashmë po riformëson peizazhin e të dhënave celulare për qytetarët dhe udhëtarët. Suksesi i

Deklaratës për Roaming BE - Ballkani Perëndimor është dëshmi e fuqisë së bashkëpunimit rajonal për ta transformuar, për ta bërë më të lehtë e më të mirë komunikimin mes vendeve, duke përballuar jo pak herë edhe sfida shumë komplekse. Ky moment historik vjen mes tensioneve politike, betejave ekonomike dhe spektrit në rritje të ndryshimeve klimatike në rajon, fakte këto që e përforcojnë edhe më shumë rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe euroatlantik", ka deklaruar sekretarja e përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu.

Ajo ka shtuar se derisa festojmë këtë arritje duhet të njohim e ta vlerësojmë përkushtimin e të gjitha palëve të përfshira, veçanërisht operatorët e telekomunikacionit. "Presim një të ardhme ku mund të jemi më të ndërlidhur, më të aksesueshëm me botën digjitale dhe të mund ta bëjmë këtë me çmime të përballueshme nga të gjithë", ka thënë Bregu.

INSTAT: Shqiptarët, pagat më të ulëta

TIRANË, 2 TETOR - Sipas raportit të fundit të INSTAT-it, shqiptarët kanë pagat më të ulëta, por punojnë me orët më të zgjatura në Evropë dhe rajon.

Një i punësuar me pagë në Shqipëri mesatarisht punoi 43.7 orë në javë në vitin 2022, nga 43.3 orë vitin e mëparshëm, publikon INSTAT.

Të dhënat e tjera të EUROSTAT-it, që matin orët e punës për shtetet e Evropës dhe disa vende të rajonit, bëjnë me dije se punonjësit shqiptarë kanë orët e punës më të gjata në Evropë, së bashku me vende të tjera të rajonit.

Në të kundërt, Holanda kishte javën më të shkurtër të punës (33.2 orë), e ndjekur nga

Gjermania (35.3) dhe Danimarka (35.4). Të dhëna të tjera tregojnë se ndonëse kanë orët më të zgjatura të punës, punonjësit shqiptarë kanë pagat më të ulëta në Evropë. Shqipëria kishte pagën më të ulët mesatare në rajon në vitin 2022, me rreth 520 euro. Ndërsa në shtetet e tjera të Evropës pagat mesatare janë mbi një mijë euro në muaj.



Euforia pas ngjarjeve në veri - kundër arsyes dhe kundër interesit kombëtar dhe shtetëror!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Lum për ne për deputetët që (s)i kemi: Se jemi euforikë, nuk ka fije dyshimi. Se politikanët që janë dhe ishin në pushtet e mbushnin dhe e mbushin këtë eufori me përmbytje që e përdorin për interesa të veta, gjithashtu nuk ka asnjë dyshim. Po se kësaj euforie i nënshtrohet edhe “ajka intelektuale dhe përfaqësuese e kombit...” - deputetët e Kuvendit të Kosovës, nuk kam besuar aq më parë që në krye të këtij institucioni është autori i disa librave filozofikë që lehtësisht mund të shpërndahen edhe si libra me barsleta, por kjo dëshmon se përvoja jetësore është e pamëshirshme - ndodhin gjëra që në rrethana normale janë të paimagjinueshme të ndodhin, së paku në një shtet normal. Policia e Kosovës ishte në nivel të detyrave të përcaktuara dhe mandatit që e ka. Madje ishte përtej këtij mandati duke u përballur me rreziqe që do të ishin sfiduese edhe për një polici që ka shumë më shumë përvojë, e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme dhe e përkrahur, pa asnjë rezervë nga institucionet përgjegjëse dhe vet shteti. Se vdekatarët e rëndomtë e vlerësojnë me respekt punën shumë profesionale të Policisë së Kosovës, nuk është befasi por se këtë e bëjnë

politikanët që deri dje ua thyenin kokat me gurë nga trotuaret e shkatërruara apo të sjellur nga terreni për ta luftuar policinë, paraqet, ose manipulim të skajshëm dhe të pafytyrë ose pendim të thellë për të kaluarën e tyre të dhunshme. Dëshiroj të jetë kjo e dyta, sinqerisht. Po e them, dëshiroj! Që mozaiku i sjelljeve euforike të bëhet komplet u përkujdesën deputetët e Kuvendit të Kosovës, me Rezolutën e votuar në seancën e fundit për ngjarjet në veri të Kosovës. Kjo Rezolutë u votua pa asnjë kundërshtim, nën ritmin e një patriotizmi folklorik, në pamundësi për të ofruar diçka që është në interes të qytetarëve të Kosovës, ndryshe votuesve të tyre sikur edhe votuesve për zgjedhjet e reja. Askush nuk e analizoi përmbytjen e kësaj Rezolute apo ndikimin e saj efektiv në ngjarjet që pashmangshëm do të jenë vazhdimësi e atyre të Manastirit të Banjskës, shumë besoj që do të jenë politike e jo policore apo ushtarake. Kuvendi i Kosovës ka traditë që të votojë Rezoluta që pastaj i vendosin në bisht të sorrës dhe ikin “si një puhizë vere...”. Ose, menjëherë pas votimit të këtyre Rezolutave, po këto rezoluta ua kanë “shkartiratë” ndërkombëtarët, ose askush nuk

është marrë me to. Realisht, edhe shumica e rezoluta që miratohen nga Kombat e Bashkuara e kanë fatin e rezolutave të Kuvendit të Kosovës me dallim që janë më profesionale. Po cila ishte perla që e votuan deputetët e Kuvendit të Kosovës e të cilin nuk do ta kishin votuar as “pleqtë e urtë të Kuvendit të Hajkobillës ..” që e kanë të qartë mandatin e tyre?! Deputetët e Kuvendit të Kosovës e votuan një pikë ku ...” Policia e Kosovës autorizohet për veprime në Veri të Kosovës...”.

Po kush janë deputetët e Kuvendit të Kosovës të votojnë kësi autorizimi kur Kushtetuta e Republikës së Kosovës qartazi cakton mandatin dhe përgjegjësinë e Policisë së Kosovës për ruajtje dhe mbrojtje të rendit kushtetues të Kosovës. Po këtë e siguron edhe Ligji për Policinë sikur që është edhe një mekanizëm që quhet Këshilli për Siguri ku janë të përfshirë krerët shtetërorë sikur edhe ata që kanë përgjegjësi në këtë fushë. E tash deputetët e Kosovës, që një numër i tyre ka angazhim fakultativ aty të dalin mbi këto institucione më të larta shtetërore, përfshirë këtu edhe Kushtetutën e vendit nuk mund të kuptohet ndryshe përveç se në Kuvend kemi mungesë të dijes

elementare për të parandaluar këtë veprim, si nga përcjellësit e trashëgimtarit të Aristotelit, Platonit, Mark Aurelit, Ciceronit apo Epiktetit e që e ka emrin Glauk Kalorësi (Konjufca nuk tingëllon aspak shqip e edhe më pak patriotik), që në rrethana normale do të duhej të mbanin përgjegjësi apo të mos paguhen për mungesën e dijes. Glauk Kalorësi është i rrethuar me njerëz të padijshëm, që nuk është aspak kriter për një vend aty dhe me njerëz servilë e që është kriteri kryesor që janë aty! Se deputetët e Kuvendit të Kosovës mund të kenë gabuar shkak se kanë shumë angazhime, është edhe e kuptueshme mirëpo se të njëjtin gabim e bëjnë këshilltarët që janë angazhuar së voni, nuk është se kuptohet dhe të pranohet aq më parë që një numër jo i vogël i tyre kanë kualifikime të larta, kanë kategori për vozitje edhe të autobusëve, janë shquar në kontrabandimin e gazit lotsjellës brenda Kuvendit, janë militantë partiakë kanë kualifikime krejtësisht nepotiste dhe cilësi të tjera që e bëjnë të domosdoshëm angazhimin e një këshilltari të mirëfilltë.

Euforia vazhdon, se vazhdon: Pas

aktit terrorist afër Manasirit në Banjskë ku humbi jetën rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku i cili e vazhdoi traditën familjare të bunjakëve në luftë kundër çdo robërimi të huaj dhe komunist si dhe tre sulmues serbë të armatosur që e rrezikuan rendin kushtetues të Kosovës, shpërtheu një rrahgjoksje e politikanëve, duke hyrë dhëndër me aletet e Policisë së Kosovës. Në vend se topi të lëshohet në tokë dhe urtësisht të analizohet situata sikur edhe veprimet e domosdoshme që duhej marrë për tejkalimin e saj, iu futën konspiracioneve që edhe për vazhduar pastaj me kryeministrin Kurti që tha se: “edhe Putini ka qenë i përfshirë këtu ...”. Natyrisht se kjo mjaftoi që një luftëtare e shquar kundër Putinit, e respektuar dhe e pranuar edhe ndërkombëtarisht për këtë, presidentja e Kosovës, Vojsa Osmani t’i përcjellë po të njëjtat fjalë që i tha kryeministri Kurti.

Është interesant që popujt e vegjël asnjëherë nuk merren me problemet reale me të cilat përballen por me çështje globale sikur që ata të jenë vendimmarrësit kryesorë. Kjo më ngjanë me një rast kur një person mendjemadh dhe i papërgjegjshëm, në vend se të merret me probleme personale dhe familjare thoshte se: "a ndjeve se ka falimentuar Behgjet Pacolli dhe se iu ka kaptur nëna Ramiz Elkosit ..., ka hyrë në borxhe deri në fytyrë". Të tillë i kemi politikanët ne, fluturojnë lart duke u ankoruar në folenë e qyqeve shkaku se nuk mund ta ndërtojnë folenë e tyre. Janë ardhacakë dhe kalimtarë në këtë vend. Të thoni se Serbia nuk ka përgjegjësi në këtë terrorizëm është e njëjtë si të thoni se në Himalaje nuk ka borë por se aty është kopshti botanik më i madh në botë. Të thoni se Vuçiqi nuk ka informata, se Vullini nuk është i përfshirë, Radojiçiqi e pranoi tërë përgjegjësinë për ta shpëtuar veten, të tjerët dhe Serbinë është sikur të thoni se njeriu i vdekur ka frymëmarrje të rregullt. Të thoni se Bashkësia ndërkombëtare sidomos shërbimet e zbulimit dhe kundërbulimit si dhe KFOR-i, UNMIK-u dhe EULESH-i, nuk kanë rol në këtë çështje është njësojë si të thoni se dielli lind në perëndim dhe jo në lindje. Pastaj, Serbia vendosi afër kufirit me Kosovën forca të mëdha ushtarake me armatim të sofistikuar për të bërë presion mbi Kosovën. Pas kësaj reagan SHBA-të dhe shtetet më të fuqishme të Evropës me kërkesë që këto forca të tërhiqen. Në pamje të parë fitohet përshtypja se ky presion ndërkombëtar ishte përcaktues që Vuçiqi filloi tërheqjen e një pjese të ushtrisë serbe ndërsa unë mendoj se realisht përcaktues për tërheqje të këtyre forcave ishte ftesa publike e këshilltarit kryesor të kryeministrit Kurti, projugosllavit të thekur, Jeton Qurroi, përfitues i luftës dhe

përfitues i imunitetit nga çdo ndjekje se: "Avijano është afër Kosovës, duhet vetëm një orë fluturim ...". Trashëgimtarët biologjikë dhe politikë të udbashëve dhe atyre që i shërbyen Jugosllavisë dhe Serbisë me besnikërinë e qenit të Sharrit, po i bien daulleve të luftës përmes radikalizimit të situatës ndonëse nuk janë në gjendje që, as edhe një pordhë të vetme ta shkrepin për Kosovën. Këta nuk e dinë çka është lufta, ishin në anën e atyre që na vranë për më shumë se një shekull dhe, në krismën e parë shkojnë aty ku ishin paraardhësit e tyre biologjikë dhe politikë. Një numër jo i vogël i qeverisë por edhe deputetëve e kanë një atdhe real tjetër, jo Kosovën apo Shqipërinë. E kanë naj grua apo burrë në ato shtete që ua kanë rregulluar letrat. Dhe ju mendoni se këta do ta bëjnë luftën, në lule jeni nëse mendoni kështu! Përsëri sakrificën dhe pasojat do t'i bartin idealistët për të përfituar horrat dhe materialistët. Tradita vazhdon! Kërkesa kryesore e liderëve kosovarë drejtuar SHBA-së dhe BE-së është që Serbisë t'i vendosen sanksionet në ndërkohë që Serbisë nuk i kanë vendosur kufizime të tilla as si përkrahëse e Rusisë që e bëri Ukrainën shkumb dhe hi dhe ku numri i viktimave është jashtëzakonisht i madhe dhe ku provohet siguria e rendit botëror. Tash bota ka rënë në pikë të hallit sepse ende nuk e ka marrë katalogun me kërkesa të sanksioneve që i kanë kërkuar presidentja Osmani, kryeministri Kurti dhe shkatërruesja e diplomacisë kosovare, Donika Katran (Shvarc) Gërvalla. Po kjo që diplomacinë kosovare e ka sjell para falimentimit po thotë se pas ngjarjeve në veri të Kosovës ka vdekur Zajebnica në ndërkohë që Vojsa Osmani thotë se këtë duhet ta bëjmë bashkë me amerikanët. Kryeministri Kurti e di se si është puna, sidomos pas Brukselit dhe

bishtit (aneksit) të Ohrit prandaj vazhdimisht po blenë kohë në përpjekje që mos të formohet Zajebnica gjatë këtij mandati qeveritar e që këtë ta përdorë si armë të fuqishme për zgjedhjet e ardhshme. Vuçiqit nuk i intereson vetëm veriu i Kosovës por dëshiron që tërë Kosovën ta mbajë në gjendje të destabilitetit të përhershëm prandaj nerbia e ka të qartë se çdo marrje e një pjese të territorit të Kosovës në Veri nënkupton se serbët që jetojnë në lokacione tjera poshtë lumit Ibër do ta kishin fatin e armenëve të Nagorni Karabahut. Deri në kohën sa Bosnja do të mbetet e bashkuar (qoftë edhe si e tillë) as Kosova nuk do të ndahet. Marrëveshja e Brukselit dhe bishti (aneksi) i Ohrit është një Kosovë e bosnjëzuar. NATO-ja ishte e pritshme se pas eskalimit të situatës do të sjellë forca shtesë në Kosovë dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama e kishte të qartë këtë prandaj i parapriu këtij procesi. Për këtë u kryqëzua si një tradhtar dhe anti shqiptar dhe anti Kosovë në ndërkohë që u lavdërua kur tre ditë më parë kundërshtoi vendimin e shteteve të BE-së duke kërkuar sanksione kundër Serbisë. Këta që po e sulmojnë Ramën e kanë mënyrë dhe të vetmen mundësi për mbijetesë publike dhe politike. Nuk është lajm nëse Rama e sulmon ndonjë "politikan" kosovarë por është lajm nëse këta "politikaj" e sulmojnë Ramën sikur që nuk është lajm nëse elefanti e shtypë një mi por kur miu i del me gjoks përpara elefantit! trupat shtesë erdhën, jo që nuk u kundërshtuan nga politikanët por se u kërkua që të jenë edhe më shumë në mbrojtje të Kosovës.

A do të ndryshojnë akterët "lehtësues" të bisedimeve, formati dhe qëllimet: Në ereksionet euforike ka kërkesa që Lajçak dhe Borrell, Eskobar dhe Blinken të

demisionohen sikur që për mandatin e tyre të kishte vendosur Kuvendi i Kosovës. Ka kërkesa që të gjitha marrëveshjet të shpallen të pavlefshme që ishte edhe premtim i IV-së gjatë fushatës zgjedhore. Asnjëra nga këto nuk do të ndodhë. Edhe nëse ndonjë emisar do të largohet, kjo nuk do të ndodhë pse kështu ka kërkuar Kurti dhe Basha por se kanë gjetur ndonjë vend më të mirë, ngritje në karrierë sikur këta prokurorët specialë të Gjykatës Raciste në Hagë, nga persekutues të udhëheqësve institucionalë dhe shtetërorë të Kosovës, presidentit Thaçi, kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, për shkak të karrierës janë shndërruar në persekutues të Donald Trampit. Lexues të kujdesshëm e kanë të qartë se në çdo kërkesë nga aleatët, midis kërkesës palëve për shtensionim, nga palët gjithashtu kërkohet zotimi i përmbushjes së marrëveshjeve të nënshkuara apo të dakorduara gojarisht që nënkupton se formati e sidomos përmbajtja nuk do të ndryshojë. Serbia po mundohet të dalë nga situata duke e sakrifkuar Radojiçiqin dhe Vullinin e që ka gjasë se do të jetë e mjaftueshme për oportunistët ndërkombëtarë. Kisha Ortodokse serbe, si Pont Pilati i lau duart nga çdo përgjegjësi duke u distancuar nga kryengritësit ndonëse ishte alfa dhe omega e këtyre shfrenimeve nacionaliste, që nga përfundimi i luftës e deri më sot. Manastiri i Banjskës është hallka e fundit e një zinxhiri të pakëputur i angazhimeve të Kishës Ortodokse serbe në shërbim të nacionalizmit serb, që nga Millosheviqi e deri te Vuçiqi. Mund të llogaritet dhe sigurisht se jemi fitues moral por kjo në asnjë mënyrë nuk do të përkthehet si fitore politike, ata që marrin vendime kanë kriteret tjera matëse, jo se në bazë se kush se sa ka të drejtë. Millosheviqi kishte

përgjegjësi për genocidin në Srebrenicë ku vrau mbi 8600 boshnjakë, në Dejtton të Ohajos u shpallë si ndërtues i paqes! Sa për rikujtim!

Dy gjëra që nuk po i kuptoj: Hashim Thaçi, president i Kosovës, Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe Rexhep Selimi, kryetar i GP të IV-së, para Gjykatës Raciste Speciale në Hagë po përballen, po të dëgjohej Prokurori Special, me burgim të përjetshëm. Këtë e mirëpresin edhe disa politikanë kryesorë në Kosovë. Së paku nuk do ta kundërshtonin këtë vendim. Kryeministri Kurti, në "euforinë" e menaxhuar ftohtë dhe saktë, në përpjekje për t'i rënduar gjendjen presidentit Thaçi, e goditi shumë imi në mënyrë të njëanshme nënshkroi ndalesën për dërgimin e FSK-së në veri të Kosovës ..." në kohën kur ky kryeministër e ka të qartë se as Policinë e Kosovës nuk mund ta dërgojë në veri pa lejen e KFOR-it dhe ndërkombëtarëve. Madje, në përpjekje për ta përbuzur "pararendësin", Kurti nuk denjoi as t'i përmend emrin. Çfarë ligësie kur shumica e këtyre policëve që po sakrifkohen në veri janë bashkëluftëtarë të "pararendësit".

E dyta, Xhelal Sfeqla u bë si me qenë reporter lufte, nuk lë gjë pa regjistruar me telefonin e tij. Triumfalisht hyri në vilën e Radojiçiqit nga na dërgoi fotografi nga brendia e vilës, përfshirë këtu edhe shapkat (papuçet) e dashnoret së Radojiçiqit. Në të njëjtën kohë nuk e dha asnjë sqarim si u lejua që Radojiçiq, bashkë me çetën e serbë me aq lehtësi dhe komoditet të tërhiqet për në Serbi. Një dreq i madh është këtu siç thoshte dikur "pararendësi" i Sfeqlës, Rahman Morina!



ESKADRONËT E VDEKJES – RECENSION

Autori përmes shpalosjes së tregimeve depërton thellë në receptorët e njeriut duke përcuar dhimbjen e plagëve nga protagonistët tek lexuesi



Dr. Sc. Salihë SALIHU

Romani Eskadronët e Vdekjes – është një trajtesë e zhanrit letrar ku autori Bardhyl Mahmuti përmes mjeteve artistike përshkruan realitetin e vuajtjeve të popullit shqiptar të shkaktuar nga politika gjenocidale e Serbisë. Autori në mënyrë të përkryer arrin të përshkruaj planifikimi dhe kryerjen e akteve mizore të Serbisë kundër shqiptarëve. Me shkathësi autori përmes shpalosjes së tregimeve depërton thellë në receptorët e njeriut duke përcuar dhimbjen e plagëve nga protagonistët tek lexuesi.

Në librin e autorit Mahmuti përmes prova faktike për lidhshmërinë direkt të udhëheqësisë serbe në kryerjen dhe zbatimin e politikës gjenocidale gjejmë gjithashtu edhe planifikimin për zhdukjen e këtyre dëshmitarëve.

Serbia e beretë kuqeve apo e eskadronëve të vdekjes ishin në gjendje të kryenin vepra më monsturoze në fundshekullin e XX-të. Serbia e beretë kuqeve kishte ndërtuar sistem strukturor të shtirë në sfondin e një strategji politiko-ushtarake gjenocidale që prodhonte frikë, tortura mizore e vrasje makabre jo vetëm kundër shqiptarëve por kundër të gjithë atyre njerëzve që ishin kundër zbatimit të politikës së tyre gjenocidale që zbatohet mbi shqiptarët. Kordoni i kësaj strukture kishte këthizën në piramidën më të lartë shtetërore, në kupolën e udhëheqjes së shtetit të cilët kishin ndërmarrë të gjitha masat, duke përdorur të gjitha mjetet për të arritur qëllimin për zgjidhjen finale të çështjes shqiptare në Kosovë.

Shteti kishte përgatitë struktura dhe planifikime strategjike për realizimin e qëllimit për ta shfarosë popullin shqiptarë nga trojet e tyre. Metodot dhe mënyrat më barbare që janë ushtruar gjatë kryerjes së gjenocidit në Kosovë në vitet 1998-1999 janë ndriçuar në romanin e Bardhyl Mahmutit. Romani vërtetë sjell dëshmi që kanë një përmbajtje trishtuese dhe jashtëzakonisht të dhimbshme por njëkohësisht sjell edhe një shpresë se krimi gjenocidal i kryer nuk heshtet por ndricohet dhe merrë ndëshkim nga

bota demokratike.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se autori në mënyrë të përzgjedhur fillon shkrimin romanit me një analogji të gjenocidit nazist mbi hebrenjtë dhe e përfundon romanin me një volum mbi 500 faqe po ashtu me një analogji. Autori me mprehtësi tërheq paralelizëm analogjikë krahasues mes nazistëve mbi hebrenjtë me atë serbëve mbi shqiptarët. Përmes tërheqjes së kësaj analogji autori e bënë më të kuptueshme konceptin e politikës gjenocidale duke paraqitur ngjashmëritë e bishave të egra të Einstasgruppen të nazistëve dhe Eskadronëve të Vdekjes që kishin qëllim shfarosjen e popullit hebrej respektivisht të popullit shqiptar.

Në roman përmbledhet metodologjia gjenocidale e ngulitur në mentalitetin e udhëheqësve serb që fillon nga shtrembërimi i së vërtetës. Dhe vërtetë në shkollat e psikologjisë është vërtetuar fuqishëm se çdo mendje kriminale ka nismën e vet duke filluar me strukturimin e gjenjeshtërtve. E mësimi për të gënjyer e për të përgënjeshtruar të vërtetat është ushqyer brezë pas brezi nga udhëheqësit serb tek populli i tyre. Gënjeshtra është ushqim për udhëheqësit serb, e sipas Dobrica Qosiqit, ish presidentit të Serbisë për

vitin 1992-1993, gënjeshtra duhej të konsiderohej si nevojë biologjike e psikologjike, kombëtare e politike për të dëshmuar intelgjencën. Dhe fatkeqësisht, kjo praktikë e shkollës së gënjeshhtërtve tek udhëheqësit e Serbisë është ende duke vazhduar dhe me çdo çmim përpiqet ta fsheh të vërtetën e njohur botërisht për kryerjen e gjenocidit serb mbi shqiptarët në Kosovë.

Metodë më të rafinuar për të ushqyer mendjen kriminale është nxitja e urrejtjes. Me qëllim të mbjelljes së urrejtjes mes popullit shqiptar e serb, sic është rasti në kafën Panda – ku njësia speciale kishte varë 6 të rinjë serb dhe akuzonte shqiptarët për këtë masakër me qëllim që ti atribuonte shqiptarëve vepra terroriste. Duke përdorur rastin e Pandës arriti kreu i Serbisë që të mobilizon serbët e malazetët që të luftonin kundër shqiptarëve. Me të njëjtin qëllim udhëheqja e Serbisë kishte financuar botimin e një libri mbi 1000 faqe me përmbajtje anti-shqiptare dhe shqiptarëve ju m'veshin vepra terroriste. Ky libër ishte përkthyer në shumë gjuhë të huaja botërore dhe shpërndahej me synim të përligjës së veprimeve të tyre gjenocidale të kryera në Kosovë. Jo vetëm gjatë luftës por edhe pas luftës së Kosovës vazhdon të mbjellë urrejtja masive ndaj çdo gjeje

shqiptare. Këtë ndjellje të urrejtjes e lexojmë te shprehjet pezhorative ndaj qenies shqiptare që Mahmuti e gjen tek përshkrimet me titujt bombastik në media duke e përdorur nofkën Shqiptar, të kryekriminelit të klanit të Zemunit, që emrin e vërtetë e kishte Dushan Spasojevic.


Në roman zbardhen metodat që qeveria e Serbisë përdor për burgimi dhe zhdukjen e së vërtetës. Çdo tentim që është bërë për të nxjerrë të vërtetën mbi Kosovë është paguar me çmim të lartë – me çmimin e jetës, me një vdekje që nxjerrët shpirti përmes torturave mizore. Në mesin e shumë mizorive përshkruhet edhe mizoria e protagonistit të librit Mifi L., gazetari me përkatësi serbe i cili demaskon fytyrën e vërtetë të regjimit gjenocidale serb. Tentativa e Mifi për të ndriçuar gjenocidin në Kosovë ishte motivuar nga rrëfimet që Mifi kishte dëgjuar nga njerëz që kishin qenë pjesëmarrës të drejtpërdrejt të ngjarjeve kur ishin kryer krimet gjenocidale në Kosovë. Këto rrëfime Mifi i kishte bërë publike në media të huaja dhe tregimet ishin më të llahtarshme se sa mund të imagjinonte ndonjë njeri. Në rrëfime tregohet për vrasjet, dhunimet, copëtimin e trupave të njerëzve deri në vdekjen e tyre, djegiet e trupave të njerëzve të të gjitha moshave. Krimi gjenocidal i serbëve ka tejkualuar

përmasat e krimeve naziste me faktin se serbët kanë shkuar më tej në shkallën e kryerjes së krimin gjenocidal duke u zbatuar me trupat e shqiptarëve. Kriminelët serb trupat e shqiptarëve jo vetëm që i kanë zierë por kanë bërë eksperiment për përdorimin e kockave të shqiptarëve si lampa elektrike.

Në roman përveç trishtimit e dhembjes nga rrëfimet e krimeve gjenocidale të serbëve mbi shqiptarët nëpër rreshta e gjejmë të spikatur edhe heroizmin e shqiptarëve të burgosur; në mesin e tyre edhe figura me emra real të burgosurve shqiptarë, si Bajrush, Naiti, Sadiku e shumë të tjerë.

Me elegancë artistike paraqiten bisedat mes protagonistit kryesor Mifi me personazhet shqiptare që janë të burgosur duke pasqyruar ngjarjet e torturave mizore që përjetuan të burgosurit shqiptar dhe të mbijetuarit e masakrës së burgut të Dubravës me 117 vdekur e mbi 400 të plagosur.

Në fund fare mund të them se romani i Mahmutit nxjerrë historinë tragjike të popullit shqiptar gjatë periudhës së luftës së fundit, vitet 1998-1999, të shkaktuar nga përdorimi i politikës gjenocidale të Serbisë në Kosovë si dhe politikës së tyre për heshtjen dhe shfarosjen e dëshmitarëve mbi gjenocidin.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Napoli pa Rrahmanin e pret Real Madridin



“Epoka e re”

PRISHTINË, 2 TETOR - Një prej ndeshjeve më të spikatura në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve ishte (e martë) do të zhvillohet në Napoli ku kampionia e Italisë, Napoli e pret Real Madridin në “Stadio Diego Armando Maradona”. Napoli në këtë përballje hyn i trimëruar pas fitoreve bindëse në fundjavë ndaj Lecces (4-0) në Serinë A, kurse fitore bindëse shënoi edhe Reali në La Liga ndaj Gironës (3-0). Skuadra e Rudi Garcias është e treta në Itali, katër pikë prapa liderit Inter, por kjo skuadër ka shënuar fitore në tri nga katër ndeshjet e fundit, duke përfshirë edhe fitoren ndaj Bragës (2-1) në ndeshjen e parë të këtij sezoni në Ligën e Kampionëve. “Blutë” arritën deri në çerekfinale të Ligës së Kampionëve në sezonin e kaluar. Napoli u takua për herë të fundit me Real Madridin në raundin e 16-të në sezonin 2016-17, me gjigantët spanjollë që fituan 3-1 si vendas ashtu

edhe si mysafirë duke u kualifikuar me rezultat të përgjithshëm 6-2. Në anën tjetër Real Madridi që ka fituar 14 Kupa Evropiane, ka qenë në formë të fortë në fillimin e këtij sezoni duke pësuar vetëm një disfatë, nga rivalët e Atletico Madridit, derisa janë në krye të La Ligës. Ndërsa në Ligën e Kampionëve, “Los Blancos” ishte larg më i mirë se Union Berlini, por arriti fitore vetëm në fund të ndeshjes me golin e Jude Bellinghamit. Historia e klubit spanjoll në garën më të fortë tregon se ata gjithmonë janë të gatshëm për fitore. Mungesa më e madhe e kampionëve të Italisë është kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, kurse mungojnë edhe Juan Jesus dhe Pierluigi Gollini. Në anën tjetër Reali do të ketë katër mungesa Eder Militao, Thibaut Courtois, Arda Guler dhe David Alaba. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi Union Berlin e pret Bragën. Ndeshje interesante do të zhvillohet në grupin A ku Manchester Unitedi e pret skuadrën e Galatasarayt. Unitedi e humbi

ndeshjen e parë nga Bayern Munchen (4-3), por sonte pret tri pikët e plota në “Old Trafford”. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi, Copenhagen e pret Bayernin që llogaritet favorit absolut për të kaluar në fazën tjetër.

| Grupi A |
|---------------------------------------|
| 21:00 FC Copenhagen - Bayern Munchen |
| 21:00 Manchester United - Galatasaray |
| Grupi B |
| 21:00 Lens - Arsenal |
| 21:00 PSV Eindhoven - Sevilla |
| Grupi C |
| 18:45 Union Berlin - SC Braga |
| 21:00 Napoli - Real Madrid |
| Grupi D |
| 18:45 FC Salzburg - Real Sociedad |
| 21:00 Inter - Benfica |

SHKURT

Xhaka: Në Leverkusen ka më pak presion

Granit Xhaka gjatë verës u transferua nga Arsenali në Bayer Leverkusen. Ai ka folur për dallimin mes klubit anglez dhe atij gjerman. Kapiteni i Kombëtares së Zvicrës ka thënë se në Gjermani ka më pak presion se në Angli dhe kjo të jep mundësinë të punosh i qetë. “Koha ime në Arsenal kishte marrë fund, kështu që vendosa të largohesha. Në Leverkusen mund të punosh në paqe. Këtu nuk ka kaos, klubet e tjera janë më shumë të fokusuar. Në Arsenal presioni ishte ndryshe. Por, ne kemi ambicie të mëdha dhe e kemi një potencial enorm në ekip”, ka thënë Xhaka për “NZZ”.

Mediet italiane thurin elozhe për Gjimshitin: Solid dhe i shkëlqyeshëm

Atalanta dhe Juventusit u ndanë baras 0-0 ditën e djeshme. Bergamezët ishin tepër të rrezikshëm dhe këtë e tregojnë shifrat dhe rastet, teksa krijuan më shumë lojë dhe u desh një mrekulli e Szczesny për ta mbajtur Juventusin në lojë. Një meritë e padiskutuar që Atalanta e mbylli ndeshjen pa pësuar gol ishte e Berat Gjimshimit, qendërmbrojtësit shqiptar, i vlerësuar me notën 6,5. “Limiton Kean në të gjitha mënyrat e lejuara, në qendër të mbrojtjes ka gjetur stabilitet dhe shkëlqim. Me kokë është i rrezikshëm në çdo goditje këndi, në një rast tremb bardhezinjtë”, shkruajnë mediet italiane.

Trajneri i Lilles: Jam shumë i kënaqur me paraqitjen e Zhegrovës

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Edon Zhegrova, ka shënuar gol për Lillen në ndeshjen ndaj Le Havres (2-0). Zhegrova e kaloi skuadrën e tij në epësi në fund të pjesës së parë, kurse pas ndeshjes ai është lavdëruar edhe nga trajneri i klubit, Paulo Fonseca. “Është e vërtetë, për momentin kemi nevojë për lojtarë si Edoni. Më duhet të them se jam shumë i kënaqur me paraqitjen e tij, jo sepse ai shënoi një gol, por sepse ai po bën një punë të mirë dhe në mbrojtje. Jam shumë i kënaqur me lojën e tij në këtë nivel”, ka thënë Fonseca. “Ai po përmirësohet, por duhet të përmirësohet ende për të luajtur. Ne nuk duhet të mendojmë vetëm për momentet sulmuese. Ne kemi nevojë për lojtarë që dinë edhe të mbrojnë. Edoni po përparon në këtë, ai ndihmoi ekipin dhe për mua kjo është më e rëndësishme se goli i tij, edhe nëse është një gol i madh”, ka deklaruar Fonseca.

Davis, MVP i javës së dytë në Superligën e basketbollit

MITROVICË, 2 TETOR - Në javën e dytë të Prince Caffè Superligës u zhvillua derbi i rivalëve të vjetër në mes të Trepçës dhe Sigal Prishtinës që u fitua nga mitrovicasit. Te “Xehetarët” më i dalluari ishte Kevin Davis, duke u

shpallur MVP i javës së dytë. Ai ndeshjen e mbylli me 19 pikë e nëntë kërcime. Davis ishte shpallur edhe MVP i Superkupës. Golden Eagle Ylli fitoi me 50 pikë kundër Istogut, ku te therandasit më i miri ishte Valon Bunjaku me

22 pikë, shtatë kërcime e tetë asistime. Peja regjistroi fitoren e dytë radhazi, ku mundi Proton Cable Prizrenin në udhëtim, ndërsa te pejanët u dalluan John Chandler me 27 pikë, katër kërcime dhe një asistim e Lis

Shoshi me 21 pikë, 12 kërcime dhe tri asistime. Bashkimi, po ashtu, regjistroi fitoren e dytë radhazi, duke mposhtur Vëllaznimin, ndërsa Samir Zekiqi ndeshjen e mbylli me 25 pikë, pesë kërcime dhe dy asistime.



Schumacheri pranë rikthimit në Formula 1

GENOLIER, 2 TETOR - Formula 1 po pret rikthimin në pistë të pilotit gjerman Mick Schumacher, që pas dy vjetësh me Haas (2021 e 2022), këtë sezon është pilot rezervë i Mercedesit. Djali i shtatë herë kampionit të botës ka nisur

kontaktet me skuadrën Alpine, makinë me të cilën pritet të garojë në botërorin Endurance 2024. Ai që konfirmoi bisedimet me 24-vjeçarin gjerman është Bruno Famin, drejtori sportiv i Alpines: "Është e vërtetë që jemi duke

biseduar me Mick për këtë mundësi, që ai të garojë me ne. Mendoj se do të ishte një mundësi e mirë për të dyja palët, por për momentin vetëm po bisedojmë. Para se të vendosim do të organizojmë edhe një test me Mick, ku do

ta shohim gjendjen e tij pas gati një viti pushim", ka shtuar Famin. Duket se Alpine kërkon një emër të njohur për t'u rikthyer protagonist sezonin tjetër. Makina aktuale drejtohet nga pilotët Sebastian Ocon dhe Pierre Gasly.



Katër skuadra në garë për trofeun e Superkupës

PRIZREN, 2 TETOR - Më 3 dhe 4 tetor në Prizren do të zhvillohet Superkupa e Kosovës në basketboll të femrat. Katër skuadra do të garojnë për trofeun e çmuar të Superkupës. Përballja e parë do të jetë në mes të Prishtinës dhe Penzës, dy skuadra me traditë në basketbollin e femrave dhe që kanë fituar shumë trofe, ndërsa kërkojnë të shtojnë edhe një në sirtarin e tyre.



Takimi i dytë zhvillohet ndërmjet Bashkimit, që është organizator i kësaj ngjarje dhe Trepçës. Prizrenaset kishin një edicion të jashtëzakonshëm, duke fituar tre

trofe dhe kërkojnë të fillojnë mbarë edhe këtë edicion. Finalja do të zhvillohet të mërkurën nga ora 17:00. Ndeshjet transmetohen në Art Motion dhe Kujtesa.

Ndeshjet gjysmëfinale

Më 3 tetor takohen:
14:00 Prishtina - Penza
17:00 Bashkimi - Trepça

Më 4 tetor takohen:
17:00 Ndeshja FINALE

Viktoria Beckham: Davidi ka qenë në depresion pas kartonit të kuq në Kupën e Botës

MIAMI, 2 TETOR - Victoria Beckham ka thënë se presioni që e ka përjetuar David Beckhemi pasi i është dhënë një karton i kuq në ndeshjen për Kupën e Botës më 1998 e ka përballur me "depresion të thellë". Në një serial të ri dokumentar të platformës "Netflix", me emrin "Beckham" që do të publikohet të mërkurën, flitet për karrierën e yllit të futbollit nga perspektiva e shumë personave të tij të afërt. Në episodin e dytë të dokumentarit, Viktoria dhe David diskutojnë për abuzimin që e kanë përjetuar në fund të viteve '90, pasi Davidi është përjashtuar prej një loje kundër Argentinës. Anglia e ka humbur lojën kundër Argentinës pas një përlëshjeje me Diego Simeonen. Viktoria ka thënë se Davidi ka qenë: "absolutisht i thyer, ka qenë copë-copë". "Ai ka qenë në depresion, në depresion të thellë. Unë e kam vuajtur shumë, ende dua t'i vras ata njerëz". Duke diskutuar për abuzimin që e ka rrethuar, Davidi është lutur "të ekzistojë një pilulë që mund t'i zhdukë disa kujtime". "E kam bërë një gabim të madh. Ma ka ndryshuar jetën. Pyetjet pasi jam kthyer 'Si mund ta



tradhtosh vendin tënd? Je për turp". Ai ka thënë se është abuzuar çdo ditë atë periudhë. "Të ecësh nëpër rrugë dhe t'i shohësh njerëzit duke të shikuar ndryshe, duke pështyrë drejt teje, duke të abuzuar, duke të thënë fjalë në fytyrë, është e vështirë. Nuk kam ngrënë, nuk kam fjetur. Kam qenë shumë keq. Nuk e dija çfarë të bëja". "Shefi (Alex Ferguson) më pati telefonuar. Më ka thënë 'David, si je?' E di që jam bërë shumë emocional. Më ka thënë 'si je, bir?' I kam thënë 'jo mirë shef'. Më ka thënë 'mirë,

mos u shqetëso për këtë punë". "Ka sjell shumë vëmendje që nuk e kam dëshiruar kurrë, sidomos për prindërit e mi, dhe nuk ia fal vetes këtë gjë. Gjëja më e vështirë ka qenë ajo që ka ndodhur, sepse unë e kam bërë gabimin". Përgjatë episodit, Viktoria ka thënë se është e vështirë të flasësh edhe tani për kërcënimet me jetë që çifti i ka përjetuar atë kohë. Ata janë bërë prindër për herë të parë në mars të vitit 1999 dhe kanë katër fëmijë: Brooklyn, Romeo, Cruz dhe Harper.

SHKURT

Hamiltoni: Nuk kam marrë kurrë një ofertë nga Ferrari

Lewis Hamiltoni dhe Ferrari janë dy botë që duket se nuk do të takohen kurrë në të ardhmen. Edhe pse është përfolur shpesh për një interesim të "kokëkuqes" për pilotin britanik, kurrë nuk ka ndodhur "martesa" mes tyre. Duket se marrëdhënia mes Hamiltonit dhe Ferrarit do të mbesë në kuadrin e fjalëve dhe thashethemeve. Ajo që e konfirmon këtë gjë është kontrata e re që shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 nënshkroi me Mercedesin deri në vitin 2025. Ndërkohë që, dy pilotët aktualë të Ferrarit, Charles Leclerc e Carlos Sainz, kanë një kontratë deri në vitin 2024 me makinën italiane. "Nuk kam menduar kurrë në karrierën time që të ndryshoj skuadër", u shpreh Hamiltoni. "Dhe, ju konfirmoj se nuk kam marrë kurrë zyrtarisht një ofertë nga Ferrari. E pranoj që kemi pasur disa biseda rastësore, por te Ferrari njoh mjaft persona. Nuk jam ndier kurrë gati për t'u transferuar në Itali", ka deklaruar Hamilton për "Blick".

Allegri: Jam i lumtur me pikën e fituar ndaj Atalantës

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, ka thënë se barazimi në ndeshjen ndaj Atalantës (0-0) e rrit vetëbesimin e "Zonjës së Vjetër". "Jam i lumtur me pikën e fituar dhe paraqitjen. Ne luajtëm mirë për 60 minuta, por mund të kishim bërë më shumë teknikisht, veçanërisht në pasimin final. Ne e mbajtëm topin në tokë, por Atalanta bëri presion të lartë. Tani ne kemi një javë për t'u bërë gati për derbin", ka thënë Allegri, i cili më pas ka deklaruar se portieri Wojciech Szczesny është ndër më të mirët në botë.

Alonso: Reali? Nuk kam biseduar me askënd

Trajneri aktual i Bayer Leverkusenit, Xabi Alonso, ka shuar zërat që e lidhin me një kalim te skuadra e Real Madridit. "Është shumë herët, sapo e mbyllëm shtatorin, kështu që nuk është një temë diskutimi për momentin", ka thënë Alonso. "Kemi përpara një sezon të tërë për ta përballur, ndaj këto thashetheme mund të ndikojnë në performancën e ekipit. Ky nuk është rasti me lojtarët e mi, të cilët e dinë se si funksionon futbollit. Këto zëra nuk kanë qenë problem për askënd. Nuk kam folur me asnjëri për diçka të tillë dhe nuk do ta bëj. Për momentin nuk na intereson", ka deklaruar Alonso.

Messi thërret Modriqin tek Inter Miami

Ish-lojtari i Real Madridit, Pedja Mijatoviç, ka zbuluar se e ardhmja e Luka Modriqit në Real Madrid mund të jetë lëkundur. Gazeta spanjolle "AS" raporton se kroati ka disa oferta dhe njëra prej tyre është nga Inter Miami. Gjatë pushimit të fundit për shkak të ndeshjeve ndërkombëtare, Modriq dhe David Beckham, bashkëpronar i klubit amerikan, u takuan dhe darkuan së bashku, sipas Mijatoviç. "Ai ka marrë oferta nga Shtetet e Bashkuara, nga shumë ekipe dhe nga kjo në veçanti. Ai tashmë kishte një nga Arabia Saudite, por donte të qëndronte në Madrid", ka thënë Mijatoviç. Lionel Messi gjithashtu raportohet se është i interesuar për mundësinë që Modriqi t'i bashkohet klubit. Raporti shton se mesfushori veteran tashmë e ka bërë të qartë se ka vënë re një ndryshim në rolin e tij te Real Madridi dhe se është i gatshëm të ndryshojë ambient.

Sampdoria në krizë rezultatesh, Pirlo rrezikon shkarkimin

Sampdoria pësoi një tjetër humbje në shtëpi, e cila e la në vendin e parafundit në Serinë B, prandaj Andrea Pirlo mund të shkarkohet. "Blucerchiati" synonin të ishin në garë për t'u

ngjitur në Serinë A pas rënies së tyre nga kjo kategori sezonin e kaluar, madje kaluan edhe në pronësinë e ish-patronit të Leeds Unitedit, Andrea Radrizzani. Drejtimi i skuadrës

i është besuar ish-trajnerit të Juventusit dhe Fatih Karagumruk, Pirlo, por sezoni ka nisur jashtëzakonisht dobët. Tifozët filluan të protestojnë gjatë humbjes 2-1

në shtëpi ndaj Catanzaros, e cila i la ata në pozicionin e parafundit me vetëm tri pikë nga tetë ndeshje. Sipas "Calciomercato", drejtuesit e klubit duket se do ta mbajnë

besimin te Pirlo të paktën deri në ndeshjen e ardhshme kundër Ascolit, duke pritur për të marrë një vendim gjatë pushimit të ndeshjeve ndërkombëtare.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “MD POSITIVE” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811424506 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “MD POSITIVE” L.L.C. Pristine donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811424506 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “MD POSITIVE” L.L.C. Pristine, has come to the decision to quit its business: 811424506 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BS Blendi” SH.P.K. Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70402503 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BS Blendi” D.O.O. Djakovica , donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70402503 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “BS Blendi” L.L.C. Djakovica, has come to the decision to quit its business: 70402503 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE
MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE
“TRAFIKU URBAN” SHA.
PRISHTINE
3686 02.10 23



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Data: 02.10.2023

Në bazë të nenit 164 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 06/L-016, nenit 5, paragrafi 5.2, nenit 16 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III/nr. 31/15 qershor 2008), dhe plotësim ndryshimeve përkatëse me Ligjin nr.04/L-111 dhe nr. 05/L-009, dhe në pajtim me normat tjera pozitive relevante, nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, nenit 13 të Statutit të NPK “Trafik Urban” SHA. Nr.1173 dt.05.04.2023, Komisioni Komunal i Aksionarëve të NPK “TRAFIKU URBAN” SHA. në Prishtinë, me datë 02.10.2023, mori këtë:

VENDIM

- Shtyhet afati i aplikimit të kandidatëve konkurrent për zgjedhjen e 4 anëtarëve të Bordit Drejtues të NPK “TRAFIKU URBAN”, Prishtinë sipas konkursit me nr.2994 dt.22.08.2023.
- Afati i aplikimit të kandidatëve konkurrent sipas pikës 1 të këtij Vendimi do të shtyhet deri me datë 13.10.2023.
- Obligohet Sekretari që këtë vendim ta publikoj në Web faqen zyrtare të Ndërmarrjes dhe në një nga mediat e shkruara ditore.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Komisioni Komunal i Aksionarëve duke marrë parasysh numrin e pamjaftueshëm të kandidatëve konkurrent për konkursin nr.2994 dt.22.08.2023 ka parë të nevojshme që kohëzgjatjen e konkursit ta shtyjë në mënyrë që të krijohet një konkurrencë më e madhe dhe të plotësohen kushtet ligjore për zgjedhjen e 4 anëtarëve të BD në NPK “TRAFIKU URBAN” SHA, në Prishtinë dhe në mënyrë që të vazhdohet me procedurat e rregullta ligjore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- IrfanBeqiri, shpall te pavlefshme dëftesat I,II,III,IV, dhe diplomën e shkollës se mesme te larte “Arkitekt Sinani”.

- Artan Vehapi shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi”Prizren.

- Festim Qafleshi shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Kushtrim Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Arben Dula shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Beis Islami shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme Medresea “Alaudin” Prishtinë.

- Isuf Gashi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe Diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të

na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

